

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ROEN SH.P.K".**

Në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) si dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"(i ndryshuar);

Sot më datë **24/01/2025**, unë **Z.Ardit Fisheku**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 08/02/1989, lindur në Ura Vajguore dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Nr.Personal I90208001C *hartojë këtë AKT THEMELIMI duke shprehur vullnetin tim te lirë si mëposhtë vijonë:*

**NENI 1
LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË**

Shoqëria Tregtare e krijuar do të ketë statusin juridik Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj tregtar është "Roen sh.p.k". Kjo shoqëri është e themeluar nga unë Z. Ardit Fisheku, një ortak i vetëm i cili zotëron 100% të vlerës së kuotave të shoqërisë duke patur rolin e ortakut themeluese të vetme.

**NENI 2
SELIA E SHOQËRISË**

Zyra Qendrore e shoqërisë tregtare "Roen sh.p.k" e ka vendodhjen në Tiranë, Selitë, Diga e Liqenit, rruga "Kristo Luarasi", Njësia tregëtare N-04, kati 0, Kuota +0.00, Kulla D, në Tiranë.

**NENI 3
REGJIMI JURIDIK**

Shoqëria është shqiptare dhe me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria "ROEN SH.P.K" fiton personalitetin juridik që në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria "ROEN SH.P.K" do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj tregtare :

- Shitja dhe blerja e monedhave të huaja për individë dhe subjekte të tjera, duke ofruar shërbime të këmbimit valutor në përputhje me ligjet dhe rregulloret përkatëse.
- Ofrimi i shërbimeve të transferimit të parave dhe shërbimeve të tjera financiare që lidhen me këmbimin valutor.
- Ofrimi i shërbimeve të këmbimit valutor për turistët dhe individët që udhëtojnë jashtë shtetit.
- Veprimtari e agentit për arketimet e pagesave për te trete në emer dhe për llogari të nje subjekti financiar jobanke.
- Kryerje e pagesave elektronike, Biletari, Siguracione.
- Rimbushje elektronike të të gjitha llojeve, pagesa gjoba makinash, tatime, pagesa të thesarit, taksa dhe tarifa vendore dhe cdo lloj veprimtarie tjetër e lejuar nga legjislacioni shqiptar.

**NENI 5
KOHËZGJATJA**

Shoqëria "ROEN SH.P.K", do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak të ligjshëm.

**NENI 6
KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "ROEN SH.P.K" përbëhet prej 2 500 000 (Dy million e pesë qind mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë e cila zotërohet 100% nga Ortaku i Vetem i Shoqërisë Z. Ardit Fisheku.

NENI 7
ADMINISTRIMI

Administrator i Shoqërisë "Roen sh.p.k" i emëruar nga Asambleja e Ortakut të Vetëm është **Z. Ardit Fisheku** me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

NENI 8
TË DREJTAT E SHOQËRISË

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

NENI 9
VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

NENI 10
SHPËRNDARJA E FITIMIT

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Ky fitim i perket ne masen 100% Ortakut te Vetem te saj.

NENI 11
LIKUJDIMI

Në këtë rast Ortaku i Vetëm marr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyren e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likujdatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesen shtesë "shoqëri në likujdim e sipër. Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

NENI 12
VULA

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 13
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërine do t'i drejtohen per zgjidhje Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Aktin e themelimit e lexova dhe e gjeta konform vullnetit tim dhe e nënshkruaj pa vërejtje.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
ADMINISTRATOR

Z. Ardit Fisheku